



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

05Nr.400/03-12323/26

Kaçanik, 28.07.2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik lidhur me KAB (Kornizën Afatmesme Buxhetore) në sektorin e Shëndetësisë, mbajtur me datë 28.07.2026, e Martë, në sallën e mbledhjeve në QKMF, me fillim pune në ora 11:00.

Të pranishëm në dëgjim publik nga Ekzekutivi ishin: Drejtoresha e DSHMS-së, Lumnie Selmanaj- Demnika dhe Drejtori i DBF-së, Valdrin Dogani.

Gjithashtu të pranishëm në këtë dëgjim publik ishin :Drejtori i QKMF-së - Dr.Sinan Zeneli, Arbnora Kuka, Dr.Ekrem Dullovi ,Filkizare Dema , Arben Koxha, Gafurr Loku, Dr.Mimoza Bajraktari, Dr.Qanije Luma, Zejnie Guri , Selvije Vila,dhe Nexhat Zharku.

Takimin e kanë udhëhequr Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Valdrin Dogani dhe Drejtoresha e DSHMS-së , Lumnie Selmanaj-Demnika.

Procesmbajtëse, Arbnora Kuka, zyrtare e lartë në shëndetësi.

Drejtori i DBF-së, Valdrin Dogani- Përshëndetje për të gjithë dhe faleminderit që keni gjetur kohë për t'iu përgjigjur ftesës sonë për dëgjim buxhetor. Ne dje kemi filluar me procesin e dëgjimeve bugjetore për përgatitjen e buxhetit për vitin 2027 dhe vlerësimeve për vitet 2028-2029. Duke ditur që shëndetësia ka grantin specifik për shëndetësi kemi parë të arsyeshme dhe të nevojshme si çdo vit të mbajm dëgjim buxhetor dhe me pjesën e sektorit të shëndetësisë. Jemi këtu bashk me drejtoreshën e DSHMS-së, Lumnie Selmanaj-Demnika. Fillimisht do ta bëjmë një prezantim të buxhetit për vitin e ardhshëm se çka përfshihet në kuadër të shëndetësisë. Në qarkoren buxhetore, në grantin specifik për shëndetësi janë të ndara në vlerë prej 1,795,737.00€ ekskluzivisht për shëndetësi. Këto mjete ndahen në kategori buxhetore për vitin 2027 : Kategorinë e pagave , për 123 punëtorë të QKMF-së, është vlera 1,358,597.00€, të kalkuluara nga ZKF, I cili është edhe zyrtar i financave në QKMF. Në kategorinë mallra dhe dhe shërbime 270,000.00€, është një ulje e buxhetit në krahasim me vitin 2026, në vlerë prej 35,000.00€. Në kategorinë e shpenzimeve komunale 35,000.00€. Në kategorinë e investimeve kapitale 205,000.00€. Totali i buxhetit për kujdesin primar shëndetësorë është 1,868,597.00€ . Te pjesa e investimeve kapitale gjatë takimeve tuaja me drejtoreshën e DSHMS-së, Lumnije Selmanaj-Demnika, ju keni kërkuar

një veturë për nevoja administrative të QKMF-së dhe e kemi ndarë një shumë prej 25,000.00€. Te investimet kapitale është edhe ndërtimi i parkingut prapa objektit të QKMF-së. Është projekt dyvjeçar, vitin 2027-180,000.00€, ndërsa në vitin 2028-230,000.00€. Buxheti është i publikuar në web faqe dhe është i hapur për propozime dhe kemi disa propozime nga Këshilli i pacientëve siç janë: Furnizimi i rregullt me barna esenciale, për të garantuar trajtim të pandërprerë dhe cilësorë për pacientët; sigurimi i materialeve esenciale mjekësore, veçanërisht pejve kirurgjik për qepje, materialeve sterile dhe materiale tjera shpenzuese të nevojshme për ofrimin e shërbimeve shëndetësore; Digjitalizimi i shërbimeve shëndetësore dhe funksionalizimi i dosjes elektronike të pacientëve ;Planifikimi i pozitës së psikologut klinik, me qëllim funksionimin e shërbimeve të shëndetit mendorë; Vazhdimi i investimeve në infrastrukturën e pajisjeve dhe kushtet e punës në institucionin e KPSH; dhe Mbështetja e programit për promovimin e shëndetit dhe edukimin e pacientëve në bashkëpunim me Këshillin e pacientëve dhe me OJQ. Ne do t'i shqyrtojmë këto propozime së bashku me stafin udhëheqës të QKMF-së. Dëgjimi është i hapur kushdo që keni për të diskutuar rreth buxhetit , urdhëroni.

Drejtori i QKMF-së, Sinan Zeneli-Përshëndetje të nderuar Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa , Valdrin Dogani, Drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Lumnie Selmanaj-Demnika, të nderuar staf shëndetësorë. Në bazë të prezantimit të buxhetit, nuk jemi keq me buxhet. Çështje që unë mendoj është shumë e rëndësishme për tu diskutuar dhe kam bërë kërkesa edhe më herët, është çështja e dezinfektimit, deratizimi dhe dezinfektimi, sidomos i hapsirave ajrore, duke e pasur parasysh që e kemi lumin Nerodime dhe pas përfundimit të luftës asnjëherë nuk është bërë dezinfektimi i hapsirës ajrore. Kjo çështje duhet të jetë prioritet në vitin e ardhshëm. Te çështja e ndërtimit të parkingjeve, unë nuk jam kundër projekteve absolutisht, por e di që hapsira tjera ne si QKMF nuk kemi. Çështje shqetësuese e para është rrezikimi i objektit të QKMF-së, çështje e dytë është se mund të del edhe ujë aty dhe mund të kemi telashe dhe çështja e treta është që nëse të ardhmen do të zgjerojmë shërbimet, shembull poliklinika specialistike, disa qendra shëndetësore kanë kërkuar dhe duhet të jenë afër objektit ekzistues.

Drejtoresha e DSHMS-së, Lumnie Selmanaj-Demnika- Ne e kemi diskutuar këtë pjesë, por nuk e di a e keni parë projektin e parkingut, do ta përcjelli dhe e shiqoni. Parkingu do të jetë nëntokësorë, por mbi parking mund të ndërtohet. Por prap do ta diskutojmë këtë projekt, sepse nuk mund ta rrezikojmë objektin e QKMF-së.

Drejtori i QKMF-së, Sinan Zeneli-Është një zgjidhje e mirë, prej 250 parkingjeve për qytetarët e komunës së Kaçanikut, por vetë kam frikë po na dëmtohet objekti pasi që e dimë si kemi ardh deri këtu e në çfarë kushte kemi qenë.

Prej vitit të ardhshëm na shtohen edhe katër pozita në QKMF, siç janë: fizioterapeuti, psikologu, logopedi dhe punëtori social. Ne e kemi planifikuar që AMF në fshatin Bob ta kenë në dispozicion, pasi është shumë afër dhe kanë hapsirën e nevojshme për të kryer shërbime.

Drejtoresha e DSHMS-së, Lumnie Selmanaj-Demnika- Ky ekip do të jenë udhëtues, në shkollë, në shpija, në qerdhe dhe kudo që është nevoja, por krijimi i hapësirës është mirë.

Drejtori i QKMF-së, Sinan Zeneli-Mirë është që do të ofrohen këto shërbime sepse ndërhyrja në fëmijëri të hershme ka shumë rëndësi për shëndetin mendor të fëmijëve. Çështje tjetër është edhe

edukimi i vazhdueshëm profesional, ku duhet të ndahet një pjesë te kategoria mallra dhe shërbime, ose të bëhet një kod i veçantë. Deri tani kemi pasur trajnerët tanë që kanë mbajtur ligjerata stafit shëndetësor, nganjëherë kemi pasur edhe ligjerues tjerë të cilë kanë mbajtur ligjerata vullnetarisht vetëm për hatrin tonë, ose përmes ndonjë kompanie farmaceutike. Mendoj që kemi mjete të mjaftueshme. Ne jemi falenderues ndaj kryetarit të komunës dhe ekzekutivit aktual, por edhe ndaj ish kryetarit të komunës dhe ekzekutivit të mëparshëm për përkrahjen e vazhdueshme që kemi pasur. Ne si institucion edhe në Ministri jemi shembull, problemet që kanë komunitat tjera për ne janë banale, të pakuptimta.

Dr. Ekrem Dullovi- Nëse ka mundësi me marr fjalën pasi i kemi disa nevoja urgjente. Në fund të muajit gusht do të kemi vizitën e parë të auditorit të jashtëm. Në muajin shtator e kemi vizitën tjetër për ISO Standardet, ku bëhet çertifikimi për Iso Standardet. Në muajin nëntorë e kemi vizitën ndërkombëtare, ne duhet t'i kemi disa standarde të plotësuara. Sa na përket ne si QKMF, mbi 80% i kemi plotësuar, ndërsa 20% procedura të cilat varen nga zyra e prokurimit. Buxhetin për ZHVP, nëse nuk ka mundësi për këtë vit, të paktën të ndahet buxhet për vitin e ardhshëm. Me ligj është 270€ për punëtorë në vit. Deri tani kanë ardh mjek, kanë mbajtur ligjerata në mënyrë vullnetare, por nuk vijn ma. Çështje tjetër është inventari i QKMF-së është pa barkode. Çështja tjetër është kontraktimi i një kompanie për mbrojtje dhe siguri në punë. Kontraktimi i kompanisë për ISO Standarde. Kontraktimi i kompanisë për fletnotimin komunitar. Planin e veprimit për shëndetësi për tri vite 2027-2030, ia kam dërguar drejtoreshës Duhet të pregatitet edhe Plan Strategjik Komunal për Shëndetësi, nga drejtoresha, por do të ndihmoj edhe unë.

Drejtoresha e DSHMS-së, Lumnie Selmanaj-Demnika- Të gjitha këto kërkesa për kontraktimin e kompanive janë në procedura të prokurimit.

Drejtori i QKMF-së, Sinan Zeneli- Si janë mundësitë për shtimin e numrit të punëtorëve në QKMF, sepse me rritjen e shërbimeve duhet të rritet edhe stafi.

Drejtori i DBF-së, Valdrin Dogani- Nëse si komunë e kemi numrin e stafit 823, do të jetë pak problem shtimi i numrit të punëtorëve në QKMF, sepse janë pozita në drejtori tjera. Do ta diskutojmë edhe me drejtoreshën e DSHMS-së edhe me Kryetarin këtë çështje.

Drejtori i QKMF-së, Sinan Zeneli- Ulja e buxhetit a ka të bëjë me rënien e numrit të banorëve? A ka gjasë që kjo të ndikoj edhe në uljen e pagave?

Drejtori i DBF-së, Valdrin Dogani- Ulje të buxhetit realisht nuk kemi, por kemi ngritje në krahasim me vitin paraprak, për 661,000.00€ në total si komunë. Kemi ulje vetëm te granti specifik për Arsim, kjo për arsye të rënies së numrit të nxënësve. Te DSHMS kemi ngritje konkretisht Kujdesi parësorë Shëndetësorë, për 109,000.00€, në krahasim me vitin 2026. Ulje kemi te kategoria mallra dhe shërbime, pasi që kemi pasur raste që në fund të vitit nuk janë shpenzuar të gjitha, për shkak të procedurave të prokurimit. Total buxheti i komunës së Kaçanikut për vitin e ardhshëm do të jetë 14,060,833.00 €.

Drejtori i QKMF-së, Sinan Zeneli- Çështje tjetër është rritja e shërbimeve në laborator, me futjen e parametrave për analiza, na shtohen edhe shpenzimet për reagenca.

Drejtori i DBF-së, Valdrin Dogani- Te kërkesa e drejtorit të QKMF-së lidhur me dezinfektimin, deratizimin dhe dezinfektimin, di që vitin e kaluar apo një vit më herët është inicuar një procedurë por nuk ishte koha e duhur për dezinfektim. Ne duhet ta dim kur është koha e përshtatshme për dezinfektim.

Drejtoresha e DSHMS-së, Lumnije Selmanaj-Demnika- Koha e përshtatshme ishte në muajt maj-qershor. Ka qenë edhe kërkesë nga qytetarët dhe e kemi diskutuar, por procedurat e prokurimit po na stopojnë për procedurat. Vitin e ardhshëm do ta bëjmë kërkesën më herët për këtë çështje.

Arben Koxha- Është dëm i madh që nuk është bërë më herët dezinfektimi, shkak i lumit Nerodime. Ne kur kemi pasur telashe me klimatizimin patjetër është deshtë të hapen dritaret në laborator, brenda 10 minutave është mbushur laboratori me mickoja, është bartës i infeksionit.

Drejtori i DBF-së, Valdrin Dogani- te pyetja e dr. Ekremit për ZHVP, kjo shkon përmes kategorisë mallra dhe shërbime, është kodi ekonomik- shërbimet këshilldhënëse kontraktuale. Komuna e Prizrenit e ka udhëhequr një procedurë përmes prokurimit, trajnimi i profesionistëve shëndetësorë në KPSH. Edhe ju mund ta udhëheqni procedurën në të njëjtën mënyrë.

Arben Koxha- Unë e dëgjova drejtorin me vëmendje për çështjen e parkingut, që projekti si projekt kur të bëhet mos të ndodh si me objektin afër që e kemi. Bëhen ndërtime, nuk ke rrjet ujësjellësi, rrjet kanalizimi, rrjet rrymës, çfarë mbikqyrje është kjo. Të paktën ta ruajm këtë objekt sepse këtë objekt të QKMF-së nuk e ka askush. Duhet të parashihet edhe sistemi i klimatizimit në objekt. Duhet ti ndërrohen gypat sistemit klimatizimit dhe të mbushen me antifriz, kërkesën e kemi dërguar në zyrën e prokurimit. Edhe një pyetje drejtoreshë, a keni paraparë për vitet e ardhshme buxhet për punë shtesë? Këtu punë shtesë është kry por asnjëherë nuk është paguar puna shtesë.

Drejtoresha e DSHMS-së, Lumnije Selmanaj-Demnika- Ne buxhet kemi, por vetëm duhet të bëhet planifikimi, normal që duhet të paguhet puna shtesë.

Filkizare Dema- Shërbimet kryhen në QKMF, por nëse ka mundësi të shtohet stafi sepse edhe shërbimet janë shtuar, sidomos te radiologjia, që të punohet edhe pas orës 13:00. Laboratori mbyllet në ora 15:00, pas kësaj kohe pacienti duhet të shkojë në Ferizaj për një analizë të leukocitëve, kështu që të shtohet staf dhe të punohet së paku deri në ora 19:00. Te urgjenca kemi pak staf meshkuj, që është pak e rëndë për femra për të bërë bartjen e pacientëve në teren. Është mirë të bëjmë diçka të mirë për popull. Edhe një kërkesë tjetër e kam për veturë për administratë të QKMF-së, sepse ne po duhet të shkojmë në takime me vetura të autoamblancës ose me veturë të vizitës që i ka stafi për nanat lehona. Jam falenderuese për këto 8 vitet e fundit, që çdo kërkesë e jona aprovet nga komuna, gjithashtu jam falenderuese edhe ndaj zyrës së prokurimit në komunë për bashkëpunim.

Drejtori i DBF-së, Valdrin Dogani- Sa i përket kërkesës së veturës e kemi të planifikuar në buxhet për vitin 2027, në vlerë prej 25,000.00€. Përndryshe ne krenohemi me objektin dhe stafin e QKMF-së.

Nexhat Zharku- Kombi të hemodializës mirë jemi por shpejt mund të mbetemi keq. Arsye është rritja e numrit të pacientëve. Kombit bëjnë kilometra shumë brenda muajit sepse shkojmë 6 herë në javë në Ferizaj për dërgimin e pacientëve. Kombi i hemodializës ka bërë shumë kilometra, kërkojmë të kemi edhe një kombi tjetër.

Drejtori i DBF-së, Valdrin Dogani- Nëse ka mundësi kjo veturë do të parashihet me buxhetin e vitit vijues, pasi që për këtë vit kemi paraparë një veturë për administratë.

Drejtori i QKMF-së, Sinan Zeneli- Për vitin 2028 do të kisha planifikuar të kemi ekipin one call, një ekip për raste urgjente, rritet efikasiteti i shërbimeve dhe shpejtësia e shërbimeve. Dhe nëse kemi mundësi të bëjmë edhe privatizimin e dializës, siç e kanë bërë disa komuna tjera. Nëse bëhet kjo nuk kemi nevojë të blejmë veturë për hemodializë.

Drejtori i DBF-së, Valdrin Dogani- Për 6 muaj të vitit 2026 kemi inkasuar të hyra në vlerë 10,000.00€ të shërbimet e kujdesit primar shëndetësorë, participime janë 5,609.00€, taksa të certifikatave mjeksore janë 3,075.00€ dhe taksa tjera administrative 1,347.00€. Krahësuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak jemi minus 3,485.00€.

Filkizare Dema- Sa i përket furnizimit me listën esenciale të barnave jemi shumë mirë, pejë për qepje nuk parashihen në këtë listë për shërbimin primar por vetëm për shërbimin sekondarë, spitalet. Fatmirësisht ne kemi në kontratë përmes komunës.

Drejtori i DBF-së, Valdrin Dogani- Ju falenderojmë për kohën që keni gjetur të jeni pjesë e këtij dëgjimi publik.

Procesmbajtëse

Arbnora Kuka

